

GJKYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 117/09

12 tetor 2010

GJKYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, me Gjyqtarët e EULEX-it Martti Harsia dhe Harri Katara dhe Gjyqtarët Kosovarë Salih Toplica dhe Gyltene Sylejmani si anëtarë të kolegjit, dhe në praninë e Zyrtarit ligjor Andrea Chmieliński Bigazzi si procesmbajtës, në lëndën penale Pkl-Kzz nr. 117/09 të Gjykatës Supreme të Kosovës;

kundër të pandehurit S. K. "Ç." or "Ç."

i akuzuar për kryerje të Krimit të Luftës të përcaktuar me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ) lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së, bazuar në aktakuzën e datës 27 korrik 2004 të ndryshuar nga ana e Prokurorit Publik më 27 korrik 2007;

I dënuar në shkallën e parë me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 10 gusht 2006, P. Nr. 85/2005 për kryerje të veprave penale të **Krimin të Luftës të Trajtimin Çnjerëzor dhe Vuajtjeve të Pamasa ose Shkelje të Shëndetit Trupor të të Burgosurve Civilë** duke aplikuar masa të frikësimit dhe terrorit në shkelje të nenit 142 të KP RSFJ-së lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së
Dhe i dënuar me shtatë (7) vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 16 shkurt 2004 deri sa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë;

I dënuar në shkallën e dytë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 371/2008, të datës 10 prill 2009 për kryerje të veprave penale të **Krimin të Luftës të Trajtimin Çnjerëzor dhe Vuajtjeve të Pamasa ose Shkelje të Shëndetit Trupor të të Burgosurve Civilë** duke aplikuar masa të frikësimit dhe terrorit në shkelje të nenit 142 të KP RSFJ-së lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së, duke vërtetuar me këtë Aktgjykimin e shkallës së parë,

Dhe i dënuar me një dënim të zvogëluar me gjashtë (6) vjet burgim;

Duke vepruar lidhur me **Kërkesën për Mbrojtjen e Ligjshmërisë** të paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit S. K., të datës 24 gusht 2009, e drejtuar kundër aktgjykimin të gjykatës së shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 10 gusht 2006 (P. Nr. 85/2005), dhe aktgjykimin të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 10 prill 2009 (Ap.-Kz. Nr. 371/2008);

Pas leximit të Përgjigjes në Kërkesën e të Pandehurit, të lëshuar nga Prokurori i Shtetit të Kosovës më 5 janar 2010 (PPK nr. 123/09), në të cilën Kryeprokurori i EULEX-it e inkurajon Gjykatën Supreme që ta refuzoj Kërkesën si të pabazuar;

Në emër të Popullit

Sipas nenit 456 të KPPK-së, lëshon këtë

AKTGJYKIM

Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë e avokatit mbrojtës të të pandehurit S [REDACTED] K [REDACTED] e datës 24 gusht 2009 kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 10 gusht 2006 (P. Nr. 85/2005), dhe aktgjykimit të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 10 prill 2009 (Ap.-Kz. Nr. 371/2008)

Refuzohet si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës do të mbulojnë nga i pandehuri S [REDACTED] K [REDACTED] siç është përcaktuar me rregullat e aplikueshme.

Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri duhet të përfshihet dhe llogaritet në kohëzgjatjen e dënimit sipas nenit 139 të KPPK-së

ARSYETIMI

I. Historia e Procedurës

(1) Kundër S [REDACTED] K [REDACTED] – i cili u arrestua më 16 shkurt 2004 dhe u dërgua në paraburgim – si dhe kundër të pandehurve tjerë Prokurori Ndërkombëtar paraqiti një aktakuzë më datë 11 shkurt 2005 për veprë të Krimit të Luftës kundër Popullatës Civile siç përshkruhet në katër pika të ndryshme lidhur me të paraburgosurit në qendrën e paraburgimit të UÇK-së në fshatin D [REDACTED] në Z [REDACTED] Komuna e R [REDACTED]. Pretendimet në këtë kontekst lidhen me arrestim joligjor, paraburgim të paligjshëm, rrahje, torturë dhe vdekje të Shqiptarëve të Kosovës.

(2) Shqyrtimi gjyqësor kundër S. K. dhe të pandehurve tjerë, që përfshin 44 seanca, filloi më 29 shtator 2005 dhe zgjati deri më 10 gusht 2006, kur ishte shpallur Aktgjykimi. Në ndërkohë, gjatë shqyrtimit gjyqësor më 27 korrik 2006 Prokurori ndryshoi aktakuzën kundër S. K. dhe gjashtë të pandehurve tjerë, duke i akuzuar ata për Krime të Luftës të Trajtimit Çnjerëzor, dhe duke tërhequr akuzat kundër dy të pandehurve tjerë.

(3) S. K. – si dhe dy të pandehurit tjerë – u shpall fajtor për **Krimit të Luftës të Trajtimit Çnjerëzor dhe Vuajtjeve të Pamasa ose Shkelje të Shëndetit** Trupor të të burgosurve civilë duke aplikuar masa të frikësimit dhe terrorit në shkelje të nenit 142 të KP RSFJ-së lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së, në veçanti të kryera në mes datës 01 maj dhe 31 gusht 1998. S. K. – si dhe dy të pandehurit tjerë – u dënua me (7) vjet burgim.

(4) S. K. u lirua me dorëzani nga paraburgimi me Aktvendim të Gjykatës së Qarkut në Prizren të datës 10 gusht 2006, bashkë me disa kushte tjera. S. K. u lirua më 11 gusht 2006. Prokurori Publik Ndërkombëtar paraqiti ankesë kundër këtij Aktvendimi, dhe Gjykata Supreme e Kosovës pranoi ankesën me Aktvendim të datës 2 shtator 2006 duke urdhëruar ri-arrestimin e S. K. dhe një të pandehuri tjetër deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. S. K. mbeti në arrati deri më 23 nëntor 2007, kur ai u arrestua në fshatin D. Që atëherë, ai është mbajtur në paraburgim deri më 10 prill 2009.

(5) Aktgjykimi i shkallës së parë i është dorëzuar të pandehurit dhe avokatit të tij mbrojtës më 5 mars 2008. Më 21 mars 2008 avokati mbrojtës i të pandehurit S. K. me kohë paraqiti ankesë kundër aktgjykimit të shkallës së parë si dhe një plotësim shtesë të kësaj anekese, të paraqitur më 07 prill 2008. Avokati mbrojtës në ankesën e tij kundërshton Aktgjykimin e shkallës së parë për shkak të shkeljeve të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin dhe prandaj propozoi që ose të ndryshohet Aktgjykimi me konstatim se nuk është vërtetuar kryerja e veprave penale për të cilat akuzohet i pandehuri dhe rrjedhimisht të lirohet i pandehuri, ose të kthehet lënda prapë në Gjykatë të shkallës së parë për rigjykim, ose të shqiptohet një dënim më i butë ndaj të pandehurit.

(6) Pas dorëzimit të dosjeve nga Gjyqtarët e UNMIK-u te Gjyqtarët e EULEX-it në janar 2009, Gjykata Supreme e Kosovës caktoi një seancë ankimore më 01 prill 2009 dhe mbajti këshillimin mbi këtë lëndë më 01 dhe 10 prill 2009. Gjykata Supreme e Kosovës në lëndën e S. K. mbështeti vendimin e Gjykatës së shkallës së parë sa i përket fajësisë së të pandehurit, por pjesërisht pranoi ankesën e avokatit mbrojtës duke marrë parasysh kohën e gjatë të kaluar në mes shpalljes së Aktgjykimit dhe përpilimit të vendimit si dhe papajtueshmërinë në mes dispozitivit dhe dëshmive të marra nga Gjykata e shkallës së parë sa i përket pjesëmarrjes së të pandehurit në arrestime dhe paraburgime të paligjshme. Prandaj, dënimi u zvogëluar në gjashtë (6) vjet burgim.

(7) Më 04 gusht 2009 avokati mbrojtës i të pandehurit S. K. paraqiti me kohë një Kërkesë për Mbrojtje të Ligjshmërisë kundër Aktgjytimeve të shkallës së parë dhe të dytë duke pretenduar në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, në veçanti të nenit 403, paragrafit 1, pikës 8 dhe 12 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe të nenit 415, paragrafit 1 të KPPK-së. Prandaj, ai propozon:

- të ndryshohen Aktgjykimet e Gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë dhe i dënuari S. K. të lirohet nga të gjitha akuzat, ose
- të anulohen Aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në Gjykatë të shkallës së parë për rigjykim.

(8) Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK) paraqiti një mendim më 6 janar 2010 dhe propozoi të refuzohet Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë si e pabazuar, pasi që nuk mund të vërehet shkelja e ligjit të procedurës penale.

(9) Gjykata Supreme e Kosovës caktoi një seancë dhe mbajti këshillimin më 12 tetor 2010.

II. Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës konstatoi si në vijim:

1. Pranueshmëria e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është e pranueshme. Kërkesa është paraqitur në gjykatën kompetente në përputhje me nenin 453 të KPPK-së dhe brenda afatit të përcaktuar me nenin 452, paragrafin 3 të KPPK-së.

2. Procedurat përcjellëse të Gjykatës Supreme

Kolegji i Gjykatës Supreme në seancë ka vendosur siç përcaktohet me nenin 454, paragrafin 1 të KPPK-së. Palët nuk ishin njoftuar për seancën, pasi që sipas nenit 451 deri në nenin 460 të KPPK-së Gjykata Supreme nuk obligohet të njoftojë palët kur merr vendim mbi Kërkesat për Mbrojtje të Ligjshmërisë.

3. Mbi meritat e Kërkesës për Mbrojtje të Ligjshmërisë

Kërkesa për Mbrojtje të Ligjshmërisë është e pabazuar.

a. Shkeljet e pretenduara të nenit 403, paragrafit 1, pikës 8 të KPPK-së

Nuk ka shkelje të nenit 403, paragrafit 1, pikës 8 të KPPK-së. Kjo vërejtje i referohet aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtjen e ligjshmërisë në veçanti ka theksuar se të dy aktgjykimet ishin bazuar në dëshmi të papranueshme si në dëshminë e marrë nga "Dëshmitari A" e cila ishte dhënë para Gjyqtarit Hetues më 26 prill 2006. Sipas mbrojtjes, deklarata e dëshmitarit është dashur të veçohet nga shkresat e lëndës siç tanimë ishin dorëzuar gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë më 25 maj 2006, dhe më vonë në kontekstin e ankesës. Mbrojtja gjithashtu propozon se do të kuptohej në mënyrë të qartë nga nenet 164, paragrafi 1; 162, paragrafi 2, dhe 87 paragrafët 2 dhe 3 të KPPK-së, se deklaratat e dëshmitarëve me "të meta të tilla" nuk mund të përdoren si dëshmi në procedura penale. Mbrojtja përfundon se madje edhe nëse pasojat e "të metave të tilla" nuk rregullohen me KPPK-në në interes të të pandehurit, dëshmitë e kundërshtuara do të duhej të veçoheshin nga dosja.

Gjykata Supreme në këtë kontekst gjen se kjo çështje tanimë është ngritur nga avokati mbrojtës gjatë shqyrtimit gjyqësor në shkallën e parë gjatë seancës së mbajtur më 25 maj 2005. Propozimi i mbrojtjes për shpalljen e deklaratës "Dëshmitari A" të dhënë para Gjyqtarit Hetues më 24 prill 2004 si të papranueshme, është refuzuar nga Gjykata. Në këtë kontekst, duhet theksuar se Gjykata e Qarkut në Prizren më parë kishte pranuar deklaratën e dëshmitarit të kontestuar si dëshmi të pranueshme me anë të Aktvendimit të datës 22 qershor 2006, në këtë mënyrë duke e dhënë arsyetimin në vijim:

"...Pas këshillimit, kolegji ka vendosur edhe pse nuk ka qenë e kontestueshme se dëshmitari nuk është udhëzuar, kjo shkelje e Ligjit nuk rezulton në papranueshmërinë e deklaratës së tij/saj hetuese (neni 153 paragrafi 1 i KPPK-së). Sa i përket mënyrës se si është intervistuar dëshmitari, kolegji ka vendosur se ka qenë çështje e vlerësimit të dëshmive".

Neni 153, paragrafi 1 i KPPK-së përcakton si në vijim:

(1) Provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës penale janë të papranueshme kur ky Kod ose dispozita të tjera të ligjit shprehimisht parashikojnë kështu.

Në këtë kontekst, ky kolegji i Gjykatës Supreme i referohet plotësisht arsyetimit të dhënë në Aktvendimin e datës 22 qershor 2006 (P.Nr. 85/2005) dhe ndanë qëndrimin e marrë në aktvendimin përkatës. Në veçanti, duhet të theksohet përsëri se neni 153, paragrafi 1 i KPPK-së nuk lejon interpretimin e dispozitës në kuptim më të gjerë, por kërkon interpretim të saktë siç është orientuar me formulimin e tij. Lidhur me këtë, është e rëndësishme të përmendet se KPPK-ja nuk përmban asnjë dispozitë e cila tregon papranueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve vetëm se dëshmitari nuk ka marrë udhëzimet e duhura ligjore siç është e përcaktuar me ligj, në veçanti me nenin 164, paragrafi 2 i KPPK-së

b. Shkeljet e pretenduara të nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së

Nuk është vërtetuar asnjë shkelje e nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së, e as nuk është bërë nga gjykata e shkallës së parë ose nga gjykata e shkallës së dytë.

Avokati mbrojtës ka kundërshtuar se arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka cekur arsyet lidhur me faktet vendimtare dhe se arsyetimi i dhënë është konfuz dhe kundërthënës në një masë të madhe.

Së pari, duhet të nënvizohet se në lidhje me të pandehurin, aktgjykimi i shkallës së parë përmend arsyet lidhur me konsideratën dhe vlerësimin e fakteve vendimtare përgjatë të gjitha 75 nga totali i 102 faqeve të aktgjykimit. Gjithashtu, dëshmitë e marra parasysish përmenden në detaje në faqet 8-11 të aktgjykimit të shkallës së parë. Prandaj, Gjykata Supreme konsideron se argumenti përkatës i mbrojtjes është i pabazuar.

Në përgjithësi, në këtë kontekst duhet të përmendet se mbrojtja është e obliguar të jep arsye specifike lidhur me shkeljen esenciale të ligjit në vend të referimit të përgjithshëm në argumentet e tij tanimë të ngritura në ankesë, siç ka vepruar në këtë lëndë. Mundësia e dhënë palëve nga KPPK-ja për paraqitjen e Kërkesës për mbrojtjen ligjshmërisë nuk duhet të konsiderohet, shfrytëzohet ose keqpërdoret si një mënyrë për të zvarritur gjykatën në vendosjen e kërkesës mbi faktet në vend të mangësive të pastra procedurale të cilat kanë mundur të arrijnë në shkelje të rëndë të drejtave të të pandehurit (ose të ndjekjes penale në kuptimin e kundërt).

Megjithatë, Gjykata Supreme gjen se lidhur me mospërputhjen e pretenduar të aktgjykimit të shkallës së parë, kjo çështje tanimë është ngritur nga mbrojtja në ankesën e tij dhe është diskutuar gjatë nga gjykata e shkallës së dytë. Kjo e fundit në veçanti ka gjetur se *“nuk ka mospërputhje në mes të dispozitivit të aktgjykimit të shkallës së parë ku i pandehuri është dënuar për pjesëmarrje në arrestimin dhe paraburgimin e kundërligjshëm të viktimave, në këtë mënyrë duke e veten përgjegjës për krime të luftës të trajtimit çnjerëzor dhe vuajtje të pamasa ose cenim i shëndetit trupor të të paraburgosurve civil...”* dhe arsyetimi i aktgjykimit të shkallës së parë siç është dhënë në faqen 37, ku në të vërtetë asnjë dëshmi nuk është sjellë mbi aktet e arrestimit të kryera nga i pandehuri. Gjykata e shkallës së dytë e ka bërë të qartë në lidhje me këtë se kundërthënia e pretenduar nuk është dhënë për shkak të faktit se aktgjykimi i shkallës së parë e ka mbajtur të pandehurin përgjegjës në disa raste për sjellje të drejtpërdrejtë dhe në disa raste për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët penale (aktgjykimi i shkallës së dytë, faqe 19 e versionit në gjuhën angleze).

Neni 403, paragrafi 1, pika 12 e KPPK-së thotë:

Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale konsiderohet nëse: [...] Dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, kundërthënës në brendinë e tij ose me arsyet e aktgjykimit, kur aktgjykimi nuk përfshin arsyetimin ose në të nuk janë

paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, kur arsyet janë plotësisht të paqarta ose kundërthënëse në masë të konsiderueshme, kur për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e shkresave ose të procesverbaleve për deklarimet e dhëna në procedurë dhe vetë këtyre shkresave dhe procesverbaleve.

Ky nen është i ngjashëm me nenin 364, paragrafin 1, pikën 11¹ të ligjit mbi Procedurën penale të aplikuar deri më 6 prill 2004. Prandaj, kjo Gjykatë Supreme i referohet Komentarit të saj ² si burim i zbatueshëm i interpretimit të këtij lloji të shkeljeve që mbrojtja ka mundur t'i zbulojë për ta bazuar kërkesën e tij. Në fakt, asnjëra prej shkeljeve relevante të përshkruara në jurisprudencën e cituar në atë Komentar nuk janë paraqitur dhe analizuar me arsyetim të qartë nga Mbrojtja.

Hapësira e manovrimit e cila i është ofruar Mbrojtjes për paraqitjen e Kërkesës në bazë të nenit 403, paragrafit 1, pikës 12 të KPPK-së, në cilindo rast duhet të balancohet me më shumë rregulla të përgjithshme dhe më me peshë nga fjalia e parë e nenit 451, paragrafi 2 i KPPK-së i cili në mënyrë të qartë thotë: “Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike [...]”. Pas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme nuk mund të thirret për të vlerësuar përsëri faktet dhe deklaratat e dëshmitarëve. Nuk mund të kërkohet nga Gjykata Supreme që të verifikojë: se dispozitivi është ndikuar në një masë të madhe sa i përket rrjedhshmërisë dhe harmonisë së përbërjes së elementeve esenciale të tij; se në brendinë e dispozitivit dhe aktgjykimit ekziston një ndarje në dy pjesë sa i përket arsyeve të vendimit; se ato arsye absolutisht mungojnë në aktgjykim ose janë plotësisht në mospërputhje me faktet e lëndës siç janë paraqitur në shqyrtimin gjyqësor; se përfundimisht arsyet e vendimit janë keqinterpretuar, ndryshuar, konfuzë, ndryshuar natyrën e thjeshtë të fakteve siç janë paraqitur në shqyrtimin gjyqësor (p.sh. përmes dokumenteve të dorëzuara dhe futura në regjistër, deklaratat e dhëna para gjykatës ose të lexuara në gjykatë, dëshmitë tjera të siguruara në shqyrtimin gjyqësor).

c. Shkelja e pretenduar e nenit 415, paragrafit 1 të KPPK-së nga Aktgjykimi i shkallës së dytë:

Avokati mbrojtës ka theksuar që gjykata e shkallës së dytë duhet të shqyrtoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën për të cilën është parashtruar

¹ I cili thotë: “[...] nëse dispozitivi i aktgjykimit ishte i pakuptueshëm, kontradiktor në brendi apo kontradiktor me bazat e aktgjykimit ose nëse aktgjykimi nuk ka pasur fare bazë ose nuk ka cituar arsyet e lidhura me faktet vendimtare ose nëse këto arsye ishin së bashku jo të qarta apo kontradiktore deri në një masë të konsiderueshme, ose nëse ka mos përputhje lidhur me faktet vendimtare në mes të asaj çka është cituar në bazat e aktgjykimit lidhur me përmbajtjen e dokumenteve apo të shënimeve lidhur me dëshminë e dhënë në procedurë dhe vetë këto dokumente apo shënime”.

² Branko Petrić, Komentet mbi Ligjin e Procedurës Penale, 1986, Botimi i dytë, Libri i pestë, Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, Beograd.

ankesa. Prapë mbrojtja mban qëndrimin pasi që aktgjykimi i shkallës së dytë do të kuptohej si përshkrim i besueshëm i aktgjykimit të shkallës së parë, Neni 415, paragrafi 1 i KPPK-së do të mund të shkelej nga Gjykata Supreme në shkallën e dytë. Në veçanti, avokati mbrojtës nxjerr në pah në kërkesën e tij që dëshmitari i mbrojtjes V. M. kurrë nuk është dëgjuar ose kurrë nuk është lexuar deklarata e tij e dhënë para gjyqtarit hetues me datën 6 qershor 2004 nga gjykata e shkallës së dytë, edhe pse ishte propozuar nga mbrojtja me datën 23 maj 2006. Për më tepër, avokati mbrojtës thekson në kontekstin përkatës që dëshmia e dhënë e në veçanti e marrë prej dëshmitarëve nuk është vlerësuar në mënyrë të duhur dhe të saktë. Posaçërisht, dëshmitarët e mbrojtjes: F. B., H. K., M. J., R. R. dhe R. L. e gjithashtu edhe "dëshmitarët anonimë X dhe Z" dhe dëshmitarët N. E. dhe H. R. fare nuk janë marrë parasysh ose gjykata e shkallës së parë nuk i është bindur atyre. Avokati mbrojtës përfundon se këta dëshmitarë nuk janë shtjelluar nga gjykata e shkallës së dytë .

Në përgjithësi, është e nevojshme të vihet në pah që në rrjedhën e Kërkesës për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të ri-vlerësoj dhe/ose të bëj zëvendësimin e të dhënave që janë marrë nga gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë. Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është e kufizuar nga ligji për çështjet siç janë paraqitur në nenin 451, paragrafin 1 (dhe nën kompetencën e prokurorit publik gjithashtu paragrafit 3) të KPPK-së. Në veçanti, Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet në bazë të përcaktimit të pretenduar, të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike (nenin 451 paragrafit 3 të KPPK-së).

Pavarësisht nga kjo, Gjykata Supreme gjen lidhur me deklaratat e dëshmitarëve siç janë theksuar nga avokati mbrojtës në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë si në vijim:

aa. Deklarata e dëshmitarit V. M.

Gjykata Supreme gjen se dëshmia e dëshmitarit V. M. ishte diskutuar në tërësi nga gjykata e shkallës së parë e gjithashtu nga gjykata e shkallës së dytë. Të dy gjykatat kanë dhënë arsye të qarta dhe shteruese se përse kjo deklaratë nuk është marrë parasysh.

Në veçanti, aktgjykimi i shkallës së dytë thotë si në vijim:

"... Gjykata e shkallës së parë ka refuzuar dëgjimin e dëshmitarit V. M. i cili para gjyqtarit hetues deklaroi se në atë kohë i pandehuri nuk ka qenë i futur në asnjë listë të ndonjë njësie por shkoi në vendet ku lufta zhvillohej. ... Në mënyrë që zyrtarisht të futet apo të mos futet në listë në grupin e posaçëm të luftëtarëve është një çështje e rëndësishme por jo aq e rëndësishme për të lënë anash përgjegjësinë penale të dikujt që në mënyrë konkrete vepron si pjesë e grupit, duke ndarë me të tjerët veprimet dhe rreziqet e tyre, dhënien dhe marrjen e urdhrave, duke supozuar përgjegjësi të drejtimit. Kjo është arsyeja pse dëshmia e V. M. siç është cituar në ankesë duket të jetë plotësisht jo relevante" (Aktgjykimi i shkallës së dytë fq. 25 e versionit në gjuhën angleze).

bb. Deklaratat e dëshmitarëve të tjerë që nuk janë marr parasysh nga gjykatat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë

Të dy gjykatat e shkallës së parë dhe të dytë kanë shtjelluar gjerësisht për dëshmitarët e treguar nga avokati mbrojtës në Kërkesën e tij për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, në veçanti të dëshmitarëve "X" dhe "Z" e gjithashtu për dëshmitarët M J R dhe R L

Të dy shkallët në veçanti kanë gjetur se "... dëshmitarët e të pandehurit S K në bazë të të cilëve mbështetet alibi i këtij të fundit nuk mund të konsiderohet neutral për të ..." pasi që "...ata ishin ish bashkëluftëtarë, shokë të ngushtë apo oficerë aktual të TMK-së me të cilin ai ka shërbyer në kohën e arrestimit të tij" (Aktgjykimi i shkallës së parë, fq. 87 dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, fq. 20, të dyja në versionin e gjuhës angleze).

Për më tepër të dy aktgjykimet kanë shtjelluar në hollësi pyetjen nëse secili prej dëshmitarëve do të jetë i besueshëm dhe nëse dëshmia e tij/saj do të mund të ndiqet. Pavarësisht, vendimi në pyetje nuk është vendi për ti përsëritur të gjitha argumentet pasi që tanimë janë peshuar dhe vënë në pah nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë. Deri më tani, referencë është bërë për aktgjykimin e shkallës së parë fq. 87- 89 të versionit të gjuhës angleze dhe të aktgjykimin të shkallës së dytë, fq. 21-25 dhe 49-50 të versionit në gjuhën angleze.

Nuk mundet përfundimisht të merret parasysh si i bazuar pohimi i avokatit mbrojtës se dëshmitarët N E dhe H R se nuk janë marr parasysh nga gjykatat e mëparshme. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të qartë i ka përdorur dëshmitë e tyre sa i përket viktimës M R dhe gjithashtu gjykata e shkallës së dytë i ka bërë referencë kësaj (aktgjykimi i shkallës së parë fq. 87 dhe aktgjykimi i shkallës së dytë fq. 45 të dyja në versionin e gjuhës angleze).

Në të njëjtën mënyrë gjithashtu dëshmitarët H K dhe F B – së bashku me M J – në mënyrë të plotë janë marrë parasysh nga gjykatat e mëparshme sa i përket rëndësisë së deklaratave të tyre. Deri më tani referencë i është bërë në veçanti aktgjykimin të shkallës së dytë fq. 24 të versionit në gjuhën angleze.

III. Përfundimi i Gjykatës Supreme të Kosovës

Për arsye të lartpërmendura, Gjykata Supreme përfundon se Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë është e pabazuar prandaj edhe duhet të refuzohet.

Si pasojë, në bazë të nenit 456 të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës vendos mbi Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë së ZPSHK-së si në dispozitiv.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
Pkl-Kzz 117/09; 12 tetor 2010

Anëtar i kolegjit

Anëtar i kolegjit

Martti Harsia

Harri Katara

Anëtar i kolegjit

Anëtar i kolegjit

Salih Toplica

Gyltene Sylejmani

Procesmbajtës

Andrea Chmieliński Bigazzi

Kryetar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi nuk mund të ushtrohet edhe një kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë (neni 451.2 të KPPK-së).

GJKYKATA SUPREME E KOSOVËS

Pkl-Kzz 117/09

19 tetor 2010

GJKYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej Gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si Kryetar i kolegjit, si edhe Gjyqtarët e EULEX-it Martti Harsia dhe Harri Katara dhe Gjyqtarët Kosovarë Salih Toplica dhe Gyltene Sylejmani si anëtarë të kolegjit, dhe në praninë e Zyrtarit ligjor Andrea Chmieliński Bigazzi si procesmbajtës, në lëndën penale Pkl-Kzz nr. 117/09 të Gjykatës Supreme të Kosovës;

kundër të pandehurit S. K., nofka "Ç." or "Ç." [redacted]
[redacted]
[redacted]
[redacted]
[redacted], i akuzuar për kryerje të Krimit të Luftës të përcaktuar me nenin 142 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP RSFJ) lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së, bazuar në aktakuzën e datës 27 korrik 2004 të ndryshuar nga ana e Prokurorit Publik më 27 korrik 2007;

I dënuar në shkallën e parë me Aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 10 gusht 2006, P. Nr. 85/2005 për kryerje të veprave penale të Krimit të Luftës të Trajtimin Çnjerëzor dhe Vuajtjeve të Pamasa ose Shkelje të Shëndetit Trupor të Burgosurve Civilë duke aplikuar masa të frikësimit dhe terrorit në shkelje të nenit 142 të KP RSFJ-së lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së
Dhe i dënuar me shtatë (7) vjet burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim nga data 16 shkurt 2004 deri sa Aktgjykimi të bëhet i formës së prerë;

I dënuar në shkallën e dytë me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap.-Kz. Nr. 371/2008, të datës 10 prill 2009 për kryerje të veprave penale të Krimit të Luftës të Trajtimin Çnjerëzor dhe Vuajtjeve të Pamasa ose Shkelje të Shëndetit Trupor të Burgosurve Civilë duke aplikuar masa të frikësimit dhe terrorit në shkelje të nenit 142 të KP RSFJ-së lidhur me nenet 22, 26 dhe 30 të KP RSFJ-së, duke vërtetuar me këtë Aktgjykimin e shkallës së parë,
Dhe i dënuar me një dënim të zvogëluar me gjashtë (6) vjet burgim;

Lidhur me Aktgjykimin të lëshuar nga Kolegji i mbajtur me datën 12 Tetor 2010 i cili ka refuzuar Kërkesën për Mbrojtjen të Ligjshmerisë të paraqitur nga Avokati Mbrojtës i të pandehurit S. K. të datës 24 gusht 2009, e drejtuar kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë të Gjykatës së Qarkut në Prizren, të datës 10 gusht 2006 (P. Nr. 85/2005), dhe aktgjykimit të shkallës së dytë të Gjykatës Supreme të Kosovës, të datës 10 prill 2009 (Ap.-Kz. Nr. 371/2008);

Duke pasur ne konsiderate se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme refuzon Kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmerisë të datës 12 Tetor 2010, faqja 10 përmban një gabim formal ne

kuptimin se Anëtarja e Kolegjit, Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Gyltene Sylejmani e ka nënshkruar aktgjykimin dy here nen emrin e saj por po ashtu edhe ne hapësirën e cila ishte e rezervuar për nënshkrimin e Kryetarit te Kolegjit;

Ne pajtim me Nenin 397 te KPPK, lëshon këtë

Aktvendim

Aktgjykimi i kësaj Gjykate Supreme i cili refuzon Kërkesën për Mbrojtje te Ligjshmërisë te datës 12 tetor 2010, ne faqen 10 përmban një gabim formal ne kuptimin se Anëtarja e Kolegjit, Gjyqtarja e Gjykatës Supreme Gyltene Sylejmani e ka nënshkruar aktgjykimin dy here nen emrin e saj por po ashtu edhe ne hapësirën e cila ishte e rezervuar për nënshkrimin e Kryetarit te Kolegjit;

Ky Aktvendim korrigjon Aktgjykimin ne kuptimin qe nënshkrimi i Gjyqtares Sylejmani nen emrin e shtypur "*Gerrit-Marc-Sprenger*" duhet te injorohet.

Nënshkrimi origjinal i Kryetarit te Kolegjit te nënshkruar ne lende është ai me ngjyre te kaltër nen shenjen e shtypur "*Kryetari i Kolegjit*".

Ky aktvendim përbehet nga 2 faqe.
I datës 19 Tetor 2010

Procesmbajtësi
Andrea Chmielinski Bigazzi

Kryetari i Kolegjit
Gerrit-Marc Sprenger